

BIBLIOTEKA  
SHËTETIT

814-37

P 8



**IDRIZ  
PONARI**

**Mirazi  
i Fundit  
ROMAN**

14-3  
P85

IDRIZ PONARI

# MIRAZI I FUNDIT

Roman

BIBLIOTEKA E SHPETIT  
GJYK. ASIER  
• INI 72152

8636

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 14.000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2306

KOMBINATI POLIGRAFIK – Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1977

## LEGJENDA E PYLLIT

Dielli kishte pushuar mbi majën e Mojanës. Breglogu shkëlqente nën rrezet e mëngjesit pranveror. Gjatë rrjedhës së përrenjve dhe kurrizeve të kodrave lartësoheshin ngadalë shtëllunga të dendura mjegulle që, sa vinin, zvogëloheshin e treteshin pa kuptuar. Mbi lulet e porsaçelura vezullonin pikat e vesës ngjyrë argjendi.

Malet e rrethonin fshatin si kurora me gjelbërim të përjetshëm. Prej malesh kishin zbritur këtu banorët e parë dhe kishin zgjedhur nga një pëllëmbë tokë anës fshatit ku ishin ngritur potanicat<sup>1</sup> e para. Kishin hapur ngasttrat e tokës pranë ndonjë burimi. Ato burime edhe sot mbajnë emra që tregojnë pronësi si «Kroi i Gjo Vatës», «Kroi i Lenës». . . Uji i këtyre krojeve derdhej në gjolin e madh ku rriteshin kashtrorja e pipëza me gjethe të mprehta, shpatuke. Nëpër to lëviznin e kuaknin në mënyrë të ethshme bretkosat. Mushkonjat i qëndronin gjolit sipër si re e zezë. Malet duhet të kenë qenë të veshura me pisha. Ato i gjejmë sot në zemër të tokës së gërryer kur vërshojnë përrenjtë e rrëmbyeshëm. Trungjet e pishave mbeten si brirë të ngulur me gjysmën e trupit të zbuluar.

Kështu janë, të zbuluar përgjysmë, edhe ca gurë të atë një bojë njeriu. Legjenda thotë se këta gurë i kite ngulur anës fushës Krah Ereçi me trimat e tij pas

---

1. kolibet

një fitoreje kundër armikut. Dhe lavdia e të rënëve ka ardhur deri në ditët tona e gdhendur me gur në legjenda, këngë, histori. . .

Banorët e Breglogut mbanin gjë të gjallë, punonin edhe atë pak tokë që kishin. Për rendin e vadës e për gurin e sinorit kanë ndodhur shumë vrasje e për to si shpëtim ka vepruar ligji i tmerrshëm i vëllavrasjes. Më 1881 në Breglog qe ndërtuar kulla e parë me mure guri të gjera tri pëllëmbë. Katin e tretë kjo kullë e kishte me kallkan e me frengji prej ku mund të vrojtoje fshatin e rrugët dhe t'i kaloje nëpër shenjestrën e pushkës. I zoti i shtëpisë kishte blerë një pushkë. Katër herë ishte djegur kjo kullë, por ende mbahej në këmbë.

Plaku Metë Demthana e mbante mend kur ishte ndërtuar kulla. Tani ai i ka kaluar të shtatëdhjetat. Sytë e kanë lënë, por këmba e tij njih çdo rrugë të fshatit. Kështu ndodhi edhe atë ditë që plaku dëgjoi një zhurmë të çuditshme në pyllin e Breglogut. Pyeti e i thanë se kishin ardhur traktorë. Plaku heshti një copë herë pa ditur ç'të thoshte. Ca makina të fuqishme shkulnin lisat me rrënjë. «Mali ynë do të bëhet fushë», — i kishin thënë. Plakut i kishin rrjedhur lot nëpër faqet e rrudhura e nga gjoksi i kishte shpërthyer një dëshirë. «Ah, sikur të kisha sy! . . .» Ishte nisur ashtu ngadalë duke u mbajtur pas shkopit dhe duke dëgjuar gjithnjë e më qartë. ato zhurmat e çuditshme të traktorëve. Kishte arritur në pyll. Këmbët e tij ishin zhytur në dheun e butë. Plaku ishte përkulur, kishte mbushur duart me dhe, kishte ndier erën e dashur të tokës dhe prapë kishte thënë: «Ah, sikur të kisha sy!». Me duart e tij si kanxha shtrëngonte dheun e tokës së dashur e nëpër sytë e mendjes i vraponte rinia e tij. . .

\* \* \*

\*

Xhavit Çelën e kishin rrethuar njerëz të moshave të ndryshme: burra, gra, pleq, djem të rinj, ndërsa fëmijët

kishin formuar një hark të gjerë rreth pusit të vadës dhe vështronin traktorin se si gërmonte dheun dhe e shtyn-  
te përpara duke formuar një pistë në formë rrethi ku do  
të mblidheshin ujërat dhe do të vadisnin arat gjatë verës.  
Xhaviti dhe burrat e fshatit bisedonin për të ardhmen e  
fshatit e të bujqësisë, ndërsa vizitorët e shumtë ndërrohe-  
shin. Të gjithë kishin ardhur për të parë traktorin. Frani,  
traktoristi, punoi derisa u err. Kur njerëzit po prisnin  
që ai ta linte punën e të ndërronin dy fjalë me të, mbetën  
të zhgënjyer. Frani ndezi dritat dhe vazhdoi punën. Ki-  
shte vendosur ta mbaronte pusin atë ditë e të nesërmen  
të kthehej në pyll ku e priste një front i ri, e prisnin sho-  
kët. Xhaviti, burrat dhe fëmijët s'u tundën nga vendi si-  
kur donin t'i bënin shoqëri traktoristit dhe të tregonin his-  
toritë e vadës dhe të pusit. Nga boka vinte një jaz i vogël  
me pak ujë. Aq pak ujë kishte, sa, po ta çoje ashtu deri në  
arë, s'mund të mbarohej një dynym tokë as për dymbë-  
dhjetë orë. Fshatarët e kishin ndërtuar atë pus shumë vjet  
më parë dhe prej atyre burrave askush s'e mbante mend,  
siç mbanin mend grindjet dhe vrasjet për vadën. Në pus  
grumbullohej uji dhe pastaj e lëshonin duke lëvizur një  
dërrasë të gjatë. Uji merrte vrull, dhe kështu më tepër  
e spërkatnin sesa e vadisnin tokën. Te gryka e pusit një-  
herë ishin vrarë tre vetë. Pusi ishte i mbyllur. Uji rritej e  
rritej gjithnjë në të. Njëri nga të vrarët kishte rënë për-  
mbys sikur donte të përqafoje tokën. Gjaku rridhte rrë-  
ke në tokën e zhuritur, pastaj në ujë. Njerëzit ishin mby-  
llur në kulla. Pusi kishte shpërthyer e uji i tij atë mëngjes  
kishte marrë udhë si asnjëherë tjetër. Kishte vërshyer du-  
ke lagur me ujë të përzier me gjak çdo vijë are dhe pastaj  
ishte derdhur në përrua...

Frani e kishte përfunduar gërmimin. Tani me traktor  
ishte ngjitur mbi pritë dhe xhironte rreth e rrotull që ta  
ngjishte e forconte pritën. Në kullat e fshatit ishin nde-  
zur dritat. Si kishte ndodhur atë natë që zhurma e trakto-  
rorit e kishte ndjekur gjumin nga çdo shtëpi?

Në mëngjes Frani u ngrit i pari dhe ndezi trakto-  
rin. Me të ishte edhe Xhaviti.

Rruga ishte e ngushtë, rrugë sajash. Fshatarët i mbrehnin qetë në saja dhe shkonin në pyll. Sajat i ndërtonin prej druri. Ato kishin një formë të çuditshme. Pas zgjedhës së qeve dy drunj formonin një kënd të ngushtë që zgjerohej aq sa të dy drunj të bashkoje me një dru tjetër që i thoshin pragu i parë e që s'ishte më i gjatë se gjashtëdhjetë centimetra. Kështu mbyllej pjesa e parë e sajës që ishte në formë trekëndëshi. Pas i ngjiteshin edhe dy lëndë paralele të gjata dy metra që mbërtheheshin në fund me një prag të dytë më të gjatë nga i pari. Mbi pragjet mbërtheheshin katër hunj të hollë dhe kështu formonin një si bagazh ku vendoseshin drutë stivë. Me saja të tilla mbanin veç druve edhe dushk, bar të thatë... Sajat përshkonin rrugët e pyjeve kryq e tërthor. Andej po kalonte tani Frani me traktorin e tij. Në të dy anët e rrugës kishte dëllinja, gurë, shkurre e ndonjë lis. Afër rrugës pylli ishte dëmtuar. Fran Vuksani ndaloi papritur dhe, si u hodh me një kërcim të shpejtë në tokë, nisi të godiste diçka me çekiçin e tij. Frani sapo ishte kthyer nga ushtria. Shërbimin e kishte kryer në flotën luftarako-detare. Kur kishte kohë, ai tregonte për shokët e për detin. Frani u ul në krah të Xhavitit dhe vijoi rrugën.

— Ç'pate, o Fran? Spinoti prapë, ë? Po të thashë unë të vinim një guzhm tel, — tha Xhaviti duke vështruar përpara se si shtroheshin nën zinxhirët e hekurt ulëzat, dëllinjat, shkurret...

Franit i qeshi fytyra nga këto fjalë që dëgjoi, po përgjigje nuk dha. Herë pas here kthehte kokën e vështronte si mbeteshin pas dy fasha rruge të shtruar me shkurre. Edhe Xhaviti i vështronte ato dhe i kujtoheshin ditët e ftohta të dimrit, kur fshatarët, të ngarkuar me dushqe, kashtë misri apo me bar të thatë kalonin aty dhe shkurret i pengonin. U nduknin ndonjë dorë bar që ishte aq i çmuar për bagëtitë në dimrin e gjatë.

Ata ecën një copë herë pa folur. Mëngjesi ishte i bukur e tashmë malet ishin përflakur nga rrezet e arta të diellit. Në horizont vraponin ca re të bardha. Malet për-

ballë ende ishin të mbuluara nga dëbora. Ato shkëlqenin e dukeshin madhështore në sfondin e kaltër.

— Shokët duhet të kenë filluar punën?, — tha Xhaviti.

— Sigurisht.

Xhaviti e vërejti Franin në fytyrë e shtoi:

— Sikur ta mbillnim pranverën e ardhshme tokën e re, sa mirë do të ishte për ne.

— Natën do ta bëjmë ditë, o Xhavit, — tha Frani, — që të çajmë ugare në këtë pyll pranverën e ardhshme, të hedhim farë me grushta edhe ne traktoristët që të kemi më shumë kallinj gruri se shkurre, dëllinja, lisa. . .

Xhavitit i shkëlqeu fytyra.

— Bash kjo na duhet, o Fran, buka. Po siguruam bukën, jemi të fortë, jemi të papërkulur. E shikon këtë pyll? Tashti ne po punojmë me traktor. Kur ishim në mal partizanë e na flisnin për këto ditë, na dukej vetja si në ëndërr. Edhe tani zhytemi për orë të tëra në ëndrrat tona të bardha për jetën e s'shqitemi dot prej tyre, sepse jemi të bindur se ato do ti jetojmë një ditë. Kjo u duhet bërë e qartë të gjithëve. Ne e kemi në dorë ta afrojmë lumturinë tonë vetëm duke punuar jo me orë e me ditë, por me vite. E ke dëgjuar mixhë Metën çfarë thotë? «Sikur të kisha vetëm për një ditë sy, do të thosha se kam jetuar jo nëntëdhjetë vjet, por një mijë. . . Vetëm të shikoj një herë këtë dritë të bukur, që zbardhi malet».

Frani e ndaloi traktorin. Xhaviti mundi të vështron-te rreth e rrotull atë shesh të madh të shpyllëzuar që i dukej ashtu i rrethuar me lisa e trungje si një vathë bagë-tish.

«Me këtë s'paskeni punuar mirë, o Fran, — tha ai me vete, duke vështruar lisat e gjatë e të drejtë të mbuluar me trungje e me dhera. — Duhet zgjeruar shkolla e re, duhet ndërtuar zyra, ambulanca. E, për të hequr këto ku m'i paskeni futur ju, more djem, do të na duhet shumë punë. Ne po mendojmë për të futur në punë edhe ato pishat që dalin nga shtresat e tokës kur vërshojnë përrenjtë. Do t'u bëjmë prita përrenjve me to e në mos, të pak-



, do t'i përdorim për dru zjarri. E kam unë fajin, mo-  
trima, që s'ju thashë juve: «Më ruani një çikë këta  
t e drejtë e vilakë, se do të na duhen për qereste, mos  
ni me gurë e me dhera. . . Besoj s'do të kishte dalë ndo-  
cipëplasar të më thoshte: «E, o Xhavit, ti do tokë të re  
të mbjellë grurë, misër, patate apo do qereste?». Eh!  
he sikur të thoshte, unë do t'i përgjigjesha: «Duam  
ne tokën, edhe qerestenë, edhe trungjet, edhe rrënjët,  
gjitha do t'i përdorim». Po jo, more, ata janë djem të  
rë, janë punëtorë. Si më tha Frani mua? «Natën do ta  
më ditë që pranverën e ardhshme këtu në vend të py-  
të gjelbërojë gruri». Po Latifi, ku është Latifi sot, pse  
është traktori i tij? — U kthye në të majtë, duke vështruar  
dej nga traktori i Latifit dhe u çudit kur e pa të he-  
tur pranë një lisi më thikë të futur në dhe. — Difekt.  
e siguri difekt. E ku rri Latifi pa punë në një ditë kur  
elli është ngjitur dy litarë mbi Mojanë?».

— Çfarë ka ndodhur, o Gjetë Jaha?, — thirri.

Pylli dremiste. Vetëm cicërimat e zogjve dëgjoheshin  
k fluturonin nëpër degët e lisave të gjatë. Nën hijen e  
ave ishte shtruar një si qilim ngjyrë kafe të hapur  
e gjethe të thata. Mbi ato gjethe dimri kishte lënë gjur-  
ët e tij dhe tani, tek depërtonin rrezet e diellit, ndihej  
ë si duhmë e rëndë trungjesh e gjethesh të kalbura.

— Ku është Latif Kana?, — pyeti përsëri Xhavit.

— Ka shkuar në qytet që mbrëmë, — foli Gjeta me atë  
rin e trashë që s'i shkonte aspak moshës së tij.

Xhavit i vështroi me radhë Gjetë Jahën, Mirash Ndo-  
n, pastaj Franin e foli:

— Po ju, more sokola, nuk dini ta ngisni traktorin a?  
o pse, more, me lutje do të shkulen gjithë këta lisa? Ja  
sëmur Latifi, do ta lini ju traktorin?

Gjetë Jaha, duke vështruar nga pylli, iu afrua një  
p Xhavitit e, si uli pak zërin, foli:

— Dje pasdite, shoku Xhavit, zbuluam një varr.

Ata vështruan lisin e gjatë, pastaj traktorin që rrin-  
i heshtur me thikë të ngulur në dhe si asnjëherë tje-

— Latifi po punonte kur thika u ngul në ledh dhe ne dalluam midis dheut një skelet njeriu dhe dyshuam.

— Pse dyshuat?, — pyeti Frani. — Këtu mund të kenë qenë varrezat e asaj kishës që tregon legjenda e mixhë Metës.

— Oh, jo, — tha Mirash Ndoci, — ai skelet nuk duhet të jetë i atyre kohëve që thonë legjendat.

— Këtu s'ka pasur kurrë varre, — tha Gjeta i vendosur sikur të qe arkeolog i vjetër. — Ai skelet na bëri të dyshonim, se ishte i futur jo shumë thellë në dhe, më pak se një metër.

— Mos ka qenë skeleti i ndonjë ushtari gjerman. Këtu është zhvillur një betejë e ashpër në kohën e Operacionit të Dimrit, — tha Xhaviti. — Janë vrarë shumë ushtarë gjermanë. Lufta s'të fal kohë për ceremoni të tilla, ndaj e kanë futur në dhe si kanë mundur.

— Kushedi, — tha Frani si me dyshim.

— Skeleti kishte një rrip në mes. Ne dalluam edhe tokëzën. Ajo kishte marrë ngjyrën e dheut nga ndryshku.

— Kjo të bën të dyshosh se i vdekuri është varrosur me rroba siç ka qenë...

— Mundet që nën rrënjët e atij lisi të jetë fshehur për vite ndonjë krim i pazbuluar, — tha Xhaviti dhe ra në mendime.

— Po Latifi pse shkoi në qytet?, — pyeti Frani.

— Latifi shkoi të denoncojë në Degën e Punëve të Brendshme, o Fran.

Frani pas pak ia filloi punës, po Latifi nuk u kthye atë ditë. Edhe Xhaviti priti deri në mbrëmje, pastaj u nis për në shtëpi.

Vonë e zuri gjumi, një gjumë i rëndë me ëndrra të shumta.

\*

\*

\*

Grupi operativ erdhi të nesërmen në orën dhjetë të mëngjesit. Ishin pesë vetë. Hetuesi, punëtori operativ, ek-